



Pranuar / Dohet Primen / Prizdate Received / Delivered	23.04.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Hi / Prot Hi / Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK/1984/2021			114



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova**  
**Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo**

Anr.181/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtare, dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit kanë shqyrtuar ankesën e datës 15.01.2019 me numër A.nr.19/2019, sipas Aktgjykimit A.nr.2229/19 të datës 22.03.2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar Avokati me adresë Kompleksi Rojal, hyrja C15/15 kati 4 Nr.23 në Prishtinë, për ankuesin kundër organit të punësimit Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike **“Kërkesë nga marrëdhënia e punës”**, duke vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.04.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr.19/2019 të datës 15.01.2019 të parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në vendin e punës „Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit”, në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Ndryshim plotësim të akt emërimit të datës 28.01.2015, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me Vendimin me numër ref. 2-100 të datës 19.01.2016, e ka pezulluar nga puna me 50 % të pagës, ankuesin për shkak se kundër tij është ngritë aktakuzës nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës me numër PSP.Nr. 23/15, me datë 29.12.2015 për veprën penale „Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” sipas nenit 422 paragrafit 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda me datë 04.10.2018 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër PKR.656/16, me të cilin ankuesi lirohet nga akuza edhe për veprën penale „Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje” nga neni 422 paragrafit 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, është liruar nga akuza me Aktgjykimin me numër PKR.nr.746/2015, të vërtetuar nga Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PAKR.nr.108/2017.

Ankuesi pasi ka pranuar Aktgjykimin me numër PKR.656/16 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda të datës 04.10.2018, ka parashtruar kërkesë me datë 22.10.2018 tek Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për kthim në vendin e punës për dy rastet penale të ngritura ndaj tij, pasi që është liruar nga akuza, nën dyshimin se ka kryer veprën penale



të keqpërdorim të pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafit 1 lidhur me paragrafin 2 nën paragrafin 2.4 të KPRK-së.

Ankuesi pasi që nuk ka pranuar përgjigje në kërkesën e tij, me datë 29.11.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, i cili me datë 26.12.2018 ka nxjerrë vendimin me nr.4994 me të cilin i është aprovuar ankesa e ankuesit si e bazuar.

Ankuesi me datë 15.01.2019 ka parashtruar ankesë më Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokoll 216/2019, me pretendime ankimore për mos zbatimin e vendimit të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe për me kthim në vendin e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 24.05.2018 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Me datë 24.01.2019 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: A.nr.2229/19 të datës 22.03.2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë; Ankesa e datës 15.01.2019 me numër protokoll 216/2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Autorizimi i përfaqësuesit avokatit Aktgjykim i datës 19.06.2017 PKR.nr.746/2015 Departamentit për Krime të Rënda; Aktgjykim i datës 19.06.2017 Gjykatës se Apelit PAKR.nr.108/2017 Departamentit për Krime të Rënda; Aktgjykim i datës 02.05.2018 PKR.nr.656/16 Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamentit për Krime të Rënda; Aktgjykim i datës 04.10.2018 PAKR.nr.403/2018 Gjykatës se Apelit -Departamentit për Krime të Rënda, të pranuar nga datë 22.10.2018 nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me numër protokoll 3227-2; Vendim i datës 26.12.2018 nr.4994 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Kërkesë e datës 22.10.2018 për kthim në vendin e punës; Certificate e datës 25.10.2018; Ankese e datës 29.11.2018 nr.4992 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Përgjigje në ankesë e datës 24.01.2018 nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Akte emërimi i datës 24.10.2011; Ndryshim plotësim i akte emërimit me datës 28.01.2015; **Kërkesë për prova shtesë për ankuesin** E-mail 21.04.2021; Prova shtesë të datës 22.04.2021 nga ankuesi E-mail i dt.22.04.2021; Vendimi i datës 19.01.2016; Urdhër për Përmbaram nr. Protokoll 4153-5 i datës 29.11.2019; Aktvendimin CP.nr.2087/19 të datës 08.11.2019; Vendimi i datës 02.12.2019; Kërkesë për përgjigje të plotë për organin e punësimit E-maili i datës 22.04.2021, **Përgjigje nga organi i punësimit, me prova shtesë** E-maili i datës 22.04.2021, me provat si në vijim: vendimi nr. Protokoll 3442-3 i datës 08.10.2019 për sistemin e ankuesit në pozitë Udhëheqës i divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike në Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në MASHT-të, Lista e Certificateve pesnisonale dhe mbajtjes së burimit të tatimit në pagë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura dhe të dërguara nga ankuesi, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit **është bërë i pamundur sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili me datë 22.10.2018 ka parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për kthim në vendin e punës, me rastin e pezullimit nga puna me 50 % të pagës sipas Vendimit me numër ref.2-100 te datës 19.01.2016, pasi ka pranuar Aktgjykimin me numër PKP.656/16 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, të datës 04.10.2018 me të cilin është liruar nga dy rastet penale, i akuzuar për veprën penale „Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” sipas





nenit 422 paragrafit 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilën e ka vërtetuar dhe Gjykata e Apelit Departamenti për Krime të Rënda, me Aktgjykimin me numër PAKP.nr.403/2018, me të cilin është refuzuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, si dhe për veprën penale „Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje”, nga neni 422 paragrafit 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, është liruar nga akuzat me Aktgjykimin me numër PKR.nr.746/2015, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PAKR.nr.108/2017, po ashtu Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm -Divizioni Civil me datë 08.11.2019 ka nxjerrë Aktvendimin me numër CP.nr.2087/19, për çështje përmbarimore si dhe Urdhrit për përmbarim me numër protokoll 4153-5 të datës 29.11.2019 i cili ka urdhëruar Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë-Sekretarin e Përgjithshme, që të zbatojë këtë urdhër përmbarimor për kthimin e ankuesit në vendin e punës „Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit”, në afat prej 3 ditëve ta informoj Gjykatën pas pranimit të këtij urdhri.

Mbi këtë bazë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se me datën 02.12.2019 Sekretari i Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, pas pranimit të Urdhrit për përmbarim me numër protokoll 4153-5 të datës 29.11.2019, ka nxjerrë Vendimin me nr. Protokoll 4143-4, me të cilin ka zbatuar Aktvendimin CP.nr.2087/19 të dt.8.11.2019 e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me të cilin ka shfuqizuar Vendimin nr.2-100 të datës 19.01.2016 duke bërë ndërprerjen e pezullimit të dhe kthimin e ankuesit në pozitë „Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit”, në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimit administrativ është bërë i pamundur, në bazë të dispozitës të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”**. Sepse në rastin konkret nga shkresat e lëndës del se ankuesi me datë 02.12.2019 Sekretari i Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka nxjerrë Vendimin me nr. Protokoll 4143-4, për shfuqizimin e vendimit për pezullim, me të cilin ankuesin e kthen në vendin e punës „Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit”, në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, duke shfuqizuar Vendimin nr.2-100 të datës 19.01.2016 për pezullim nga puna me 50 % të pagës, Vendimin nr.2-115 të datës 21.01.2016 dhe Vendimin nr.2-3442-3 të datës 08.10.2019 për sistemimin e ankuesit në pozitë

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.nr.181/2021.**

Zyle Millaku-GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

*Vendimi i dërgohet:*

- *Përfaqësuesit avokatit \_\_\_\_\_ (ankuesin \_\_\_\_\_),*
- *Gjykatës Themelore Prishtinë-Gjyqtares Lirije Maksutaj*
- *Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ,*
- *Udhëheqësit të Personelit në Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*

